

Njoftim për përqendrimin që i referohet krijimit të një sipërmarrjeje të përbashkët plotësisht funksionale nga Ford Motor Kompani, SHBA, BMV (SD) Holding Korp. SHBA dhe Amerikan Honda Motor Ko., Ink., SHBA

(lënda nr. 08-24 /2024)

Në përputhje të nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 22.01.2024, te Komisioni i Mbrojtjes së Konkurrencës është dorëzuar një njoftim për përqendrim, që i referohet krijimit të një sipërmarrjeje të përbashkët plotësisht funksionale nga Ford Motor Kompani, me zyrë të regjistruar në One Amerikan Road, Dearborn, 48126 Miçigen, SHBA, BMV(SD) Holding Korp. me zyrë të regjistruar në 300 Çestnat Rixh Road, NXH 07677 Vudklif Lejk, SHBA dhe Amerikan Honda Motor Ko., Ink. me zyrë të regjistruar në 1919 Torens Bul., Torens, SA 90501, SHBA.

-Grupi Ford është një grup ndërkombëtar automobilistik që projektton, prodhon, plason dhe ofron shërbime të një linje të plotë kamionësh Ford, vetura komunale dhe automjete - të cilat përfshijnë gjithnjë e më shumë versione të elektrizuara - dhe automjete luksoze Linkoln (*lincoln*). Grupi Ford ofron gjithashtu shërbime financiare nëpërmjet Ford Motor Kredit Kompani(*Ford Motor Credit Company*) dhe është aktiv në elektrifikimin, zgjidhjet e mobilitetit (përfshirë shërbimet e automjeteve vetë-drejtuese) dhe shërbimet e lidhura të automjeteve.

- Grupi BMW është një prodhues global i makinave dhe motoçikletave, duke përfshirë pjesë rezervë dhe pajisjet e nevojshme. Grupi BMW gjithashtu ofron shërbime financiare, lizing dhe shërbimet e marrjes me qira të makinave (d.m.th. shërbime dhe zgjidhje të mobilitetit) për klientët privatë dhe të biznesit. Grupi BMW kryesisht operon me katër marka: BMW, MINI, Rolls-Royce Motor Cars dhe BMW Motorrad.

-Grupi Honda është një prodhues japonez i pajisjeve origjinale ("**POO**"(ang."**OEM**")) që prodhon dhe shet automobila (përfshirë automjetet elektrike hibride (*ang. plug-in hybrid electric vehicles*) dhe automjete elektrike me bateri ("**EVB**" (angl. *BEV*)). " (BEV)), motoçikleta dhe produkte me kapacitet elektrik (p.sh. motorë me qëllime të përgjithshme si gjeneratorët dhe avionët (avionët privatë, avionët me gaz dhe pjesët e tyre).

Pasi të krijohet, ÇarxhSkejp - i cili do të jetë funksional vetëm në SHBA dhe Kanada - do të jetë aktiv në ofrimin e shërbimeve të rrjetit për shoqëritë e shërbimeve elektrike dhe operatorët e sistemit, përmes menaxhimit inteligjent të ngarkesës dhe grumbullimit të të dhënave të energjisë së baterisë së automjeteve elektrike.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të mbërrijnë në Komision në afat prej 10 ditësh nga data e publikimit të këtij njoftimi.

25.01.2024
Shkup